



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SKRAPAR

KËSHILLI I BASHKISË

VENDIM

Nr. 90 datë 27/09/2018

PËR

**MIRATIMIN E PLANEVE TE MBARËSHTRIMIT TE PYLLIT PRIVAT TE GJYSHATËS BEKTASHIANE ,TEQJA PRISHTË DHE TË PYLLIT PRIVAT TË PËRFAQËSUESIT Z.SHPETIM DYRMISHI .**

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 54/e, ligjin nr.9385 datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar, neni 5,pika 5, VKM nr.438 datë 08.06.2016 “Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore”, vendimit nr. 06 datë 11.10.2005 të KVKKP Qarku Berat dhe kërkesës së pronarëve të pajisur me dokument pronësie nga ZVRPP për miratim të planeve të mbarështimit.Këshilli i Bashkisë pasi mori në shqyrtim materialin nga grupi i punës së Ndërmarrjes së Shërbimit Pyjor

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e planit të mbarështimit të pyllit privat me pronar Gjyshata Bektashiane Skrapar ,Teqja Prishtë dhe miratimin e planit të mbarështimit të pyllit privat të përfaqësuar nga z.Shpetim Dyrmishi .

Vendimi miratohet me 10 vota pro, — vota abstenim, — vota kundër.

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat.

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**PARTIZAN GORÇE**

